



PK. S.H.A.
Posta e Kosovës S.H.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Prishtinë
Nr./No./№: 01-540/2024
Data/Date/Datum: 29-02-2024
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

Nr. 17/24
Datë: 27/02/2024

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit bazik nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me nenin 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Bazik për Ndërmarrjet Publike, nenit, nenit 30 pika 8 të Statutit të ndërmarrjes nr.01-198-1/2024 të datës 24.01.2024, nenit 15 paragrafi 3 pika 10 dhe nenit 25 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, Vendimit nr.01-2795/23 të datës 24.11.2023, Konkursit nr.01-2845/23 të datës 30.11.2023, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Posta e Kosovës" Sh.A. në takimin nr.4 të datës 27.02.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Kandidate e suksesshëm për pozitën e punës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit sipas konkursit nr.01-2845/23 të datës 30.11.2023 zgjidhet znj. Nermin Misini;
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit janë të përcaktuara me ligjet në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes;
3. Mandati i pozitës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit sipas pikës 1 të këtij vendimi është 3 vite;
4. Kompensimi bëhet sipas politikave të brendshme të ndërmarrjes;
5. Obligohet znj. Misini që brenda 30 ditëve pas pranimit të detyrës të bëjë deklarinimin e pasurisë sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1 e Ligjit nr.08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave;
6. Vendimi hynë në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve me vendimin nr.01-2795/23 të datës 24.11.2023 kishte shpallur konkurs publik nr.01-2845/23 të datës 30.11.2023 për pozitën e punës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit në NPQ "Posta Kosovës" Sh.A.

Në konkursin për Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit kishin aplikuar gjithsej 9 kandidat. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të aplikacioneve 6 kandidat kanë plotësuar kriteret e konkursit ndërsa 3 kandidatë nuk kanë plotësuar kriteret e konkursit, të cilëve iu është dhënë mundësia që në afat prej 3 ditëve të paraqesin vërejtjet e tyre.

Në intervistë me gojë kanë marrë pjesë 5 kandidatë, prej të cilëve pas intervistimit me më së shumti pikë nga Bordi i Drejtorëve është vlerësuar znj. Nermin Misini.

Bordi i Drejtorëve konstaton që i gjithë procesi i rekrutimit për pozitën e punës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit ka qenë transparent, i rregullt dhe në bazë të Ligjit, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative si dhe në bazë të Statutit të ndërmarrjes dhe përzgjedhja e kandidatës së suksesshme është bërë në mënyrë meritore në bazë të profesionalizmit dhe performancës së treguar në intervistë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
Hyrmët Mydyti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj padi në afat prej 30 ditëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Ndërmarrja Publike Qendrore "Posta e Kosovës" SH.A. Rr.28 Nëntori Nr.4, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

www.postakosoves.com